

VENDIM
Nr. 699, datë 26.11.2025

**PËR TRANSFERIMIN NË PRONËSI TË BASHKISË GRAMSH TË PASURISË
ME NR. 7/16, ZONA KADASTRALE 1842, ME VENDNDODHJE NË NJËSINË
ADMINISTRATIVE GRAMSH, DHE PËR NJË SHITESË NË VENDIMIN NR. 431,
DATË 11.7.2007, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR MIRATIMIN E LISTËS
PËRFUNDIMTARE TË PRONAVE TË PALUAJTSHME PUBLIKE, SHITETËRORE,
QË TRANSFEROHEN, NË PRONËSI OSE NË PËRDORIM, TË BASHKISË
GRAMSH, TË QARKUT TË ELBASANIT”, TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 5, 7 e 8, të ligjit nr. 8744, datë 22.2.2001, “Për transferimin e pronave të paluajtshme publike të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore”, të ndryshuar, me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Transferimin në pronësi të Bashkisë Gramsh të pasurisë me nr. 7/16, zona kadastrale 1842, me vendndodhje në Njësinë Administrative Gramsh, sipas formularit dhe planit të rilevimit që i bashkëlidhen këtij vendimi, për t’u përdorur për ndërtimin e një pike të trajtimit të mbetjeve të gjelbra.

2. Pasuria e përcaktuar në pikën 1 të këtij vendimi i shtohet listës përfundimtare të pronave të paluajtshme publike shtetërore, që i bashkëlidhet vendimit nr. 431, datë 11.7.2007, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e listës përfundimtare të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, që transferohen, në pronësi ose në përdorim, të Bashkisë Gramsh, të qarkut të Elbasanit”, të ndryshuar.

3. Bashkisë Gramsh i ndalohet ta tjetërsojë ose ta ndryshojë destinacionin e përdorimit të pasurisë së përcaktuar në pikën 1 të këtij vendimi.

4. Ngarkohen Bashkia Gramsh dhe Agjencia Shtetërore e Kadastrës për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama

1.FORMULAR PËR INVENTARIZIMIN E PRONAVE TË PALUAJTSHME SHTETËRORE
(Për inventarizimin e pronave të veçanta)

Identifikoi:
Bashkia / Gramsh

Supervizoi:
Fusha e përdorimit të Pronës:

Aprovoi:

Aljeta Bora (Përgjegjëse e Administrimit të Pronave)
(emri, mbiemri, pozicioni zyrtar)

Orgent Çoniku (Drejtor i Planifikimit dhe Kontrollit të Territorit Mjedisit dhe Pronës)
(emri, mbiemri, pozicioni zyrtar)

Besion Ajazi (Kryetar i Bashkisë)
(emri, mbiemri, pozicioni zyrtar, tel., firma, vulë)

Nr. Rend.	A			B			Funksioni për të cilin përdoret Prona	Institucioni / Enti në pronësi	Institucioni / Enti përdorues Statusi juridik i përdorimit	Të dhëna të tjera (Shënime të veçanta)
	Zona Kadastr. & Indeksi i Hartës	Nr. Pasurisë	Lloji i Pronës	Emri i Pronës Adresa	Sip. Totale e Pronës (m²)	Nga Sip. Totale: Sa Ndërtesë (m²)				
1	2	3	4	5	6	7	8	9	10	11
521	1842 GR-F-3	7/16	Truall	Lagjia "Holta" Gramsh	3530.4m²	0	Pikë e trajtimit të mbetjeve të gjelbërta dhe të riciklueshme për ekonominë qarkulluese	Bashkia Gramsh	Bashkia Gramsh	
1	2	3	4	5	6	7	8	9	10	11

PLAN RILEVIMI PER PUNIME KADASTRALE

PRONARI: SHTET

DATE: 29/07/2025


QELIMI: KALIM PRONESIE

VENDNDODHJA

BASHKIA: GRAMSH DVASHK: GRAMSH ZONA KADASTRALE: 1842 NR PASURIE: 7/16 VOL: 9 FQ: 63 INDEX: GR-F-3

TE DHENAT E PASURISE

LLOJI I PASURISE: TRUALL SIP.PASURISE: 3530.4m² SIP.GJURMES SE NDERTIMIT: 00.00m² NR KATEVE: 00.00KT
y:4526548.710 x:515293.931 KORNIZA REFERUESE GJEODEZIKE SHQIPTARE y:4526548.710 x:515493.051



y:4526406.106
x:515293.931

SHKALLA 1 : 1000

SHPJEGUESE

y:4526406.106
x:515493.051

NR	ORIENTIMI	NR PASURIE	TIPI I KUFITARIT	SHENIME
2	VERI	shlet		
3	LINDJE	shlet		
4	JUG	shlet		
	PERENDIM	shlet		

☐ Pasuria me numer 7/16 truall me sipërfaqe 3530.4m² me pronare Shtet
☐ Me ngjyre te kuqe eshte konturi i prones qe kerkoet kalim pronesie

REALIZOI PER SUBJEKTIN

BASHKIA GRAMSH

Specialisti Topograf Shkelqim Xharo

NENSHKRIMI/VULA

KONFIRMOI

PERGJEGJESI/DREJTORI

NENSHKRIMI/VULA

TEKNOLOGJIA E MATJEVE : Z-Zyre, O-Ortofoto, G-Gps, S-Stacion total, D-Matje Distancash

PERCAKTIMI I KUFIRIT :

Kodet per percaktimin e kufirit : P-Perfaqesues i pronareve ,K-Kufitare te gjithë, KP-Kufitare Pjeserisht

PB-Perfaqesues bashkie ,HK-Harte kadastrale

SHENIME TE VECANTA :

Plani Rilevimit hartohet me kerkese te zyres se aseleve Bashkia Gramsh

MIRATOI
DREJTORI I PLANIFIKIMIT DHE ZHVILLIMIT TE TERITORIT

ORIENTONIKU

